

KONTRATË DHURIMI KUOTE KAPITALI

E lidhur në Tiranë, sot më 22/05 / 2023, nga dhe ndërmjet:

Dhuruesi: Altin Lala, atësia Dod, shtetas Gjerman, lindur në Tirane, me adresë Wegenerstrasse 8, 30175, Hanover, Gjermani, lindur më 18/11/1975, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me pasaportë me nr. C21875Y0X;

dhe

Pranuesi i dhurimit: "ALF HOLDING" shpk, një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar e që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS M02012012H dhe seli në Rruga "Medar Shtylla", Pallati nr. 56, Hyrja 4, Apartamenti nr.26, Kodi postar 1020, Tiranë, e përfaqësuar ligjërisht nga Administratori i vetëm i saj z. **Aris Lalaj**, shtetas shqiptar, lindur më 6.2.1997 e banues në Tirane;

MEQENESE:

- Dhuruesi është ortak i shoqërisë tregtare "**Rossmann-Lala**" shpk, një shoqëri e themeluar e që funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT **K81921001A**, me seli në adresën: **Rruga Mine Peza, Rossmann & Lala, Zyrrat kati i dyte, Tirane**, (me poshtë referuar "**Shoqëria**"), dhe zotëron **25%** të kapitalit;
- Dhuruesi dëshiron t'i dhurojë Pranuesit të Dhurimit dhe ky i fundit dëshiron të pranojë dhurimin e **25% (njëzet e pesë përqind)** të kapitalit të Shoqërisë;
- Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901/2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Palët dëshirojnë të lidhin këtë Kontratë.

PER SA ME SIPER, palët bien dakord si vijon:

- Me nënshkrimin e kësaj Kontrate Dhuruesi i dhuron Pranuesit të Dhurimit i cili pranon dhurimin dhe fiton pronësinë mbi 1 kuote që përfaqëson **25% (njëzet e pesë përqind)** të kapitalit të Shoqërisë "**Rossmann-Lala**" shpk.
- Dhurimi behet pa kushte, kufizime apo barra dhe kalimi i pronësisë mbi pjesën e kapitalit konsiderohet i kryer në momentin e lidhjes së kësaj Kontrate.
- Pas lidhjes së kësaj Kontrate dhe regjistrimit të saj në regjistrat përkatës, Dhuruesi largohet nga Shoqëria, Pranuesi i Dhurimit do të zotërojë 1 kuote që përfaqëson **25% (njëzet e pesë përqind)** të kapitalit të Shoqërisë.
- Dhuruesi deklaron dhe garanton Pranuesin se pjesët e kapitalit të transferuara këtu, janë në pronësinë e tij të plote e ligjore dhe të lira nga barra hipoteke apo pengje.
- Palët bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të Kuotës objekt të kësaj Kontrate, pranë Qendrës Kombëtare e Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër Shqiptar sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

Kjo Kontratë u hartua në 3 (tri) kopje origjinale në gjuhën Shqipe dhe pasi u lexua prej palëve, u gjet e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht nga palët si vijon:

DHURUESI

Altin Lala

Altin Lala

PRANUESI I DHURIMIT

ALF HOLDING shpk,

Administrator

Aris Lalaj

Aris Lalaj



VENDIM
I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE
“ALF HOLDING” shpk.

Sot, me date 22 / 05 / 2023, ortaku i vetëm i shoqërisë ALF HOLDING SHPK (ne vijim “Shoqëria”), shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar e krijuar e që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Numër Unik Identifikimi M02012012H, me kapital themeltar 100.000 leke, me seli në Rruga “Medar Shtylla”, Pallati nr. 56, Hyrja 4, Apartamenti nr.26, Kodi postar 1020, Tiranë, pasi shqyrtoi pikat e mëposhtme të rendit të ditës:

1. Pranimi i dhurimit të kuotës prej 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit të zotëruar në shoqërinë “Rossmann-Lala” shpk. nga ortaku i saj Altin Lala;
2. Te tjera eventuale;

Ne përputhje me dispozitat e Statutit të shoqërisë dhe Ligjin 9901/2008, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Te pranoje dhurimin e kuotës që përfaqëson nëpërmjet dhurimit të 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit të zotëruar në shoqërinë “Rossmann-Lala” shpk. me NUIS K81921001A nga ortaku i saj Altin Lala në favor të Shoqërisë. Kontrata / marrëveshja përkatëse mund të konkludohet ndërmjet palëve pa kufizim me miratimin e këtij vendimi.
2. **Autorizohet administratori i Shoqërisë për lidhjen e kontratës së dhurimit.**
3. Ky Vendim depozitohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me kërkesat e Ligjit 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe Ligjit 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

Duke mos pasur çështje të tjera për të diskutuar e vendosur, mbledhja u mbyll.

